

LIGJ
Nr. 51/2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 91/2013, “PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK
MJEDISOR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në pikën 1 të nenit 10 fjalët “të licencuara nga Qendra Kombëtare e Licencimit” zëvendësohen me fjalët “të regjistruara në regjistrin tregtar me objekt veprimtarie hartimin e raporteve”.

Neni 2

Pika 3 e nenit 12 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në rast se ministria konstaton të meta ose pasaktësi në dokumentet e paraqitura brenda 7 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës, i kërkon autoritetit propozues plotësimin e tyre brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës. Në rast se autoriteti propozues nuk plotëson të metat ose pasaktësitë brenda afatit të kërkuar, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet bashkë me aktet e tjera.”.

Neni 3

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14
Ankimi

Grupet e interesit, përfshi edhe publikun, kanë të drejtën e ankimit administrativ ndaj deklaratës së ministrit dhe qëndrimit të ministrisë brenda 30 ditëve nga njoftimi për nxjerrjen e deklaratës apo qëndrimit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Administrative.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 6.7.2023.

Shpallur me dekretin nr. 144, datë 20.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.